

NOTE INFORMATIVE

Tiranë, më 18.03.2025

Mbi kërkesën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për procedim disiplinor me masën “Vërejtje publike” ndaj gjyqtarës A.Xh.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka filluar hetimin disiplinor me iniciativë, ndaj magjistrates A. Xh., me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, për shkeljen disiplinore të parashikuar, si “*Shkelja e përsëritur ose e rëndë e rregullave të solemnitetit, rregullave të sjelljes në marrëdhëniet me magjistratët e tjerë*”, në referim të nenit 102, pika 2, shkronja “dh” e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Ky hetim ka filluar mbi bazën e shqyrtimit të informacionit të pasqyruar në procesverbalin e një mbledhje të përgjithshme të gjyqtarëve të shtatorit 2024, gjatë së cilës janë zhvilluar debate mbi disa procese pune në gjykatë.

Nga analiza ligjore e fakteve të konstatuara gjatë hetimit disiplinor ndaj gjyqtarës A. Xh., rezulton se:

- Magjistratja A. Xh. në cilësinë e anëtarit të trupit gjykues ka shkelur rregullat e sjelljes me magjistratët e tjerë, pjesë e trupit gjykues, gjatë zhvillimit të një seance publike.
- Sjellja e magjistrates ka qënë e vazhdueshme gjatë gjithë seancës, duke cenuar besimin e palëve të pranishme në seancë tek drejtësia, diskretituar pozitën dhe figurën e magjistratit dhe cenuar integritetin dhe reputacionin e gjykatës.
- Shkelja disiplinore nga ana e magjistrates është kryer me dashje direkte, vërtetuar kjo edhe nga deklaratimet e dhëna nga vetë magjistratja gjatë hetimit disiplinor.
- Nisur nga mos normalizimi i marrëdhënies së magjistrates subjekt hetimi disiplinor me dy magjistratet e tjera, mbetet rreziku i sjelljeve të papërshtatshme në vijim.
- Rrethanë lehtësuese: Magjistratja e ka pranuar që sjellja e saj në praninë e palëve, në atë seancë publike nuk ka qënë në përputhje me etikën dhe se ajo nuk duhet të kishte atë sjellje në prezencë të palëve.
- Rrethanë lehtësuese: Magjistratja nuk ka masë të mëparshme disiplinore dhe ka eksperiencë të pakët profesionale, pasi shkelja është kryer në vitin e parë të punës si gjyqtare.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë konkludon se sjellja dhe veprimet e magjistrates A. Xh., në rastin konkret vlerësohen si “*Shkelje e lehtë disiplinore*”. Vetë masa disiplinore përmban *parandalimin e posaçëm*, në kuptimin që magjistrati në të ardhmen të mos kryejë më shkelje disiplinore; dhe *parandalimin e përgjithshëm*, në kuptimin që magjistratët e tjerë, të kuptojnë që një sjellje e tillë e papërshtatshme nuk duhet kryer, pasi është e ndëshkueshme me masë disiplinore.

Për sa më sipër, kërkohet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor pranimi i kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për caktimin e masës disiplinore “*Vërejtje publike*” për gjyqtaren A.Xh., të parashikuar nga neni 105 pika 1 shkronja “b” dhe neni 107 i ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.